



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.034/2016

Prishtinë, më 17 maj 2016,

PROCESVERBAL

Mbledhjen e kryesoi Lirije Kajtazi, kryetare, ndërsa i ndihmoi Salihe Mustafa, nënkryetare e Komisionit.

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiç, Mexhide Mjaku-Topalli dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Valdete Bajrami, Teuta Haxhiu, Mytaher Haskuka dhe Etem Arifi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zrytare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bivolaku-EVO/EUSR, Osman Shatri-HANDIKOS, Shefki Kastari-NDI, Mërgime Kajtazi-KDI, Teuta Haxhibeqiri-UNHR, Hajrudin Skenderi – Ambasada e Zvicrës.

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, i hapi punimet e mbledhjes së sotme, sipas propozimit të rendit të ditës të paraqitur dhe të dërguar anëtarëve të Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit funksional, ndërsa në vazhdim Komisioni i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,*

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin Nr.05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë,

3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Anëtarët e Komisionit miratuan pa asnjë vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25.4.2016.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin Nr.05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Kryetarja, fillimisht vlerësoi si shumë të mirë punën e bërë nga Grupi punues dhe në përgjithësi nga Komisioni.

Ajo më tej theksoi se amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional i kanë mbështetur edhe komisionet e përhershme dhe nuk kanë dhënë vërejtje.

Kryetarja, në fund tha se ecuria e shqyrtimit dhe sqarimet tjera në lidhje me Projektligjin dhe amendamentet e propozuara, janë pasqyruar dhe arsyetuar në këtë Raport, i cili do të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Në vazhdim, kryetarja hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Nenad Rashiç, diskutoi në lidhje me amendamentin e propozuar nr. 3, duke shpreh mendimin se lidhja e këtij kompensimi me pagën minimale ndoshta nuk është zgjidhja më e qëlluar, mirëpo ky amendament i Komisionit funksional është miratuar nga Komisioni dhe nëse ka dilema, ne si deputetë do ta arsyetojmë në mbledhje plenare.

Salihe Mustafa, tha se në bazë të punës së bërë në këtë Projektligj, ka mundur të procedohet për mbledhje plenare edhe pa shqyrtimin e sotëm në Komision dhe se sqarimet eventuale lidhur me amendamentet do t'i japim në mbledhje plenare pa asnjë hezitim, sepse si të tilla janë të arsyeshme.

Në vazhdim, kryetarja, e hodhi në votim miratimin e Raportit përfundimtar për Projektligjin Nr.05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Anëtarët e Komisionit miratuan njëzëri Raportin për Projektligjin Nr.05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimi i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, me amendamentet e propozuara.

3. Të ndryshme

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit për arsyen e mosrealizimit të takimeve monitoruese në Komunën e Pejës dhe të Prizrenit.

Nenad Rashiq ngriti çështjen e emërimit të zëvendësve të Avokatit të Popullit, me theks të veçantë atë të zëvendësit të Avokatit e Popullit nga radhët e pakicës serbe.

Lirije Kajtazi tha se çështjen e zgjidhjes së zëvendësve të Avokatit të Popullit do ta shqyrtojmë në Komision në mbledhjen e radhës.

Mexhide Mjaku-Topalli, ngriti çështjen e përvjetorit të zhdukjes së Ukshin Hotit.

Ajo kujtoi se Kuvendi ka nxjerr rekomandimet lidhur me këtë çështje dhe propozoi që Komisioni, brenda javës, të takohet me Komisionin qeveritar për Persona të Zhdukur.

Lirije Kajtazi, tha se në takimin e radhës do të ftohen në mbledhje edhe Komisioni qeveritar për Persona të Zhdukur dhe të bisedojmë për progresin në këtë drejtim.

Në tryezën e mbajtur para disa ditësh, me zëvendëskryetaren e Komisionit jemi dakorduar për formimin e grupit punues.

Rekomandimet e tryezës janë të miratuara dhe si të tilla e obligojnë edhe Komisionin funksional parlamentar.

Në vazhdim mbledhjen e kryesoi zëvendëskryetarja e Komisionit, znj.Salihe Mustafa.

Kujtim Paçaku i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me takimin me deputetët e parlamentit evropian.

Ai kërkoi që Komisioni të vazhdojë me vizitat monitoruese nëpër komuna.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se lidhur me fatin e personave të zhdukur, në mesin e tyre edhe fati i Ukshin Hotit, është biseduar edhe në takimin me eurodeputetën znj.Ulrike Lunaçek.

Në lidhje me rekomandimet e nxjerra nga Kuvendi për këtë çështje, nuk dimë se a është ndërmarrë ndonjë hap për zbatimin e tyre.

Ajo pastaj njoftoi gjerësisht edhe lidhur me ecurinë e monitorimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Në fund, ajo propozoi që dëgjimi publik lidhur me monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, të mbahet me dt. 24 maj 2016.

Nënkryetarja Salihe Mustafa, pas pëlqimit të anëtarëve të Komisionit, konstatoi se dëgjimi publik lidhur me monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, të mbahet me dt. 24 maj 2016.

Diskutimet e deputetëve: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli dhe Kujtim Paçaku, janë dhënë të plota në arkivën elektronike të administratës së Komisionit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 13:50.

Kryetarja e Komisionit

Lirije KAJTAZI

*Procesverbalin e hartoi:
Stafi mbështetës i Komisionit*